

**LIGJ**  
**Nr.9686, datë 26.2.2007**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7895, DATË 27.1.1995 “KODI  
PENAL I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 81 pika 2 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në ligjin nr.7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

**Neni 1**

Në nenin 7 shkronja “c” paragrafi i dytë, fjalët “akte terroriste” zëvendësohen me fjalët “vepra me qëllime terroriste”.

**Neni 2**

Pas nenit 7 shtohet neni 7/a me këtë përmbajtje:

**“Neni 7/a**  
**Juridiksioni universal**

Ligji penal i Republikës së Shqipërisë është i zbatueshëm edhe për shtetasin e huaj, që ndodhet në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe nuk është ekstraduar, i cili jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë ka kryer njërin nga veprat e mëposhtme:

- a) krime kundër njerëzimit;
- b) krime lufte;
- c) gjenocid;
- ç) vepra me qëllime terroriste;
- d) torturë.

Ligji penal i Republikës së Shqipërisë është i zbatueshëm edhe për shtetasin e huaj, që jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë kryen ndonjërin nga veprat penale, për të cilat ligje të veçanta ose marrëveshje ndërkombëtare, ku Republika e Shqipërisë është palë, përcaktojnë zbatueshmërinë e legjislacionit penal shqiptar.”.

**Neni 3**

Në nenin 8, fjalët “nenit 7” zëvendësohen me fjalët “neneve 7 e 7/a”.

**Neni 4**

Në nenin 28 bëhen këto ndryshime:

- a) paragrafi i dytë i pikës 1 shfuqizohet;
- b) pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Organizata terroriste është një formë e veçantë e organizatës kriminale, e përbërë nga dy ose më shumë persona, që kanë një bashkëpunim të qëndrueshëm në kohë, me synim kryerjen e veprave me qëllime terroriste.”.

#### Neni 5

Paragrafi i fundit i nenit 31 shfuqizohet.

#### Neni 6

Në nenin 50, pas shkronjës “i” shtohet shkronja “j” me këtë përmbajtje:

“j) kryerja e veprës e shtyrë nga motive që kanë të bëjnë me gjininë, racën, fenë, kombësinë, gjuhën, bindjet politike, fetare ose sociale.”.

#### Neni 7

Në nenin 78, në fund të paragrafit të dytë shtohen fjalët “si dhe me gjobë nga pesëqind mijë lekë deri në tre milionë lekë”.

#### Neni 8

Neni 83/a ndryshohet si më poshtë:

“Neni 83/a

Kanosja serioze për hakmarrje ose gjakmarrje, që i bëhet një personi për t’u mbyllur në shtëpi, dënohet me burgim deri në tre vjet, si dhe me gjobë nga njëqind mijë lekë deri në një milion lekë.”.

#### Neni 9

Pas nenit 83/a shtohet neni 83/b me këtë përmbajtje:

“Neni 83/b

#### **Nxitja për gjakmarrje**

Nxitja e të tjerëve për hakmarrje ose gjakmarrje, kur nuk përbën veprë tjetër penale, dënohet me burgim deri në tre vjet, si dhe me gjobë nga njëqind mijë lekë deri në një milion lekë.”.

#### Neni 10

Neni 86 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 86

#### **Tortura**

Kryerja me dashje e veprave, nëpërmjet të cilave një personi i janë shkaktuar vuajtje të rënda, fizike apo mendore, nga një person, që ushtron funksione publike, ose me nxitjen apo miratimin e tij, të hapur ose të heshtur, me qëllim:

- a) për të marrë prej tij ose një tjetri informata ose pohime;
- b) për ta ndëshkuar për një veprim të kryer ose që dyshohet të jetë kryer prej/ose një personi tjetër;
- c) për ta frikësuar ose bërë presion mbi të ose një person tjetër;
- ç) për çdo qëllim tjetër të bazuar në çfarëdolloj forme diskriminimi;
- d) çdo akt tjetër çnjerëzor apo poshtërues;

përbëjnë vepër penale dhe dënohen me burgim nga katër deri në dhjetë vjet.”.

#### Neni 11

Në nenin 140 hiqen fjalët “pa leje”.

#### Neni 12

Paragrafi i parë i nenit 170/b “Konkurrenca e paligjshme nëpërmjet dhunës” ndryshohet si më poshtë:

“Kryerja, gjatë ushtrimit të veprimtarisë tregtare, e veprimeve të konkurrencës me anë të kërcënimit ose dhunës dënohet me burgim nga një deri në katër vjet.”.

#### Neni 13

Në paragrafin e parë të nenit 192/b “Ndërhyrja në transmetimet kompjuterike” hiqen fjalët “përbën kundërvajtje penale dhe”.

#### Neni 14

Titulli i kreut VII ndryshohet: “VEPRA ME QËLLIME TERRORISTE”.

#### Neni 15

Neni 230 ndryshohet si më poshtë:

#### “Neni 230

#### **Vepra me qëllime terroriste**

Kryerja e veprave të mëposhtme, me qëllim përhapjen e panikut në popullatë ose për të detyruar organe shtetërore, shqiptare ose të huaja, të kryejnë ose të mos kryejnë një akt të caktuar, ose për të shkatërruar apo destabilizuar, në mënyrë serioze, struktura thelbësore politike, kushtetuese, ekonomike ose sociale të shtetit shqiptar, të një shteti tjetër, institucioni apo organizate ndërkombëtare, dënohet me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet ose me burgim të përjetshëm.

Veprat me qëllime terroriste përfshijnë, por nuk kufizohen në:

- a) veprat kundër personit, të cilat mund të shkaktojnë vdekjen ose plagosjen e rëndë;
- b) pengmarrjen ose rrëmbimin e personit;
- c) shkatërrimin serioz të pronës publike, infrastrukturës publike, sistemit të transportit, sistemit të informacionit, platformave fikse kontinentale, pronës private në përmasa të mëdha, duke rrezikuar jetën e personave;
- ç) rrëmbimin e avionëve, anijeve ose të mjeteve të tjera të transportit;
- d) prodhimin, mbajtjen, blerjen, transportin ose tregtimin e lëndëve shpërthyesë, armëve të zjarrit, atyre biologjike, kimike, nukleare, si dhe kërkimin shkencor për prodhimin e armëve të shkatërrimit në masë, të përmendura më sipër;
- dh) shpërndarjen në mjedis të substancave të rrezikshme, si dhe shkaktimin e zjarreve, të përmytjeve, shpërthimeve, me qëllim rrezikimin e jetës së personave ose shkaktimin e dëmeve të mëdha financiare;
- e) shkaktimin e ndërprerjes së furnizimit me ujë, energji elektrike ose çdo burim tjetër të rëndësishëm.”.

## Neni 16

Pas nenit 230/ç shtohet neni 230/d me këtë përmbajtje:

“Neni 230/d

### **Grumbullimi i fondeve për financimin e terrorizmit**

Grumbullimi i mjeteve financiare të çdo lloji, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, për financimin e organizatave ose kryerjen e veprave me qëllime terroriste, dënohet me burgim nga katër deri në dymbëdhjetë vjet dhe me gjobë nga gjashtëqind mijë deri në gjashtë milionë lekë.”.

## Neni 17

Neni 231 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 231

### **Rekrutimi i personave për kryerjen e veprave me qëllime terroriste ose të financimit të terrorizmit**

Rekrutimi i një ose më shumë personave për kryerjen e veprave me qëllime terroriste ose të financimit të terrorizmit, edhe kur këto vepra drejtohen kundër një shteti tjetër, institucioni apo organizate ndërkombëtare, nëse nuk përbën vepër tjetër penale, dënohet me burgim jo më pak se dhjetë vjet.”.

## Neni 18

Neni 232 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 232

### **Stërvitja për kryerjen e veprave me qëllime terroriste**

Përgatitja, stërvitja dhe dhënia në çdo formë e udhëzimeve edhe në mënyrë anonime ose në rrugë elektronike, për prodhimin ose përdorimin e lëndëve eksplozive, armëve të zjarrit dhe municioneve luftarake, të armëve të tjera dhe lëndëve kimike, bakteriologjike apo bërthamore ose të çdo natyre tjetër, të dëmshme dhe të rrezikshme për njerëzit dhe pasurinë, si dhe të teknikave e të metodave të tjera për kryerjen e veprave me qëllime terroriste dhe pjesëmarrja në veprimtari të tilla, edhe kur këto vepra drejtohen kundër një shteti tjetër, institucioni apo organizate ndërkombëtare, nëse nuk përbën vepër tjetër penale, dënohen me burgim jo më pak se shtatë vjet.”.

## Neni 19

Pas nenit 232 shtohen nenet 232/a dhe 232/b me këtë përmbajtje:

“Neni 232/a

### **Nxitja, thirrja publike dhe propaganda për kryerjen e veprave me qëllime terroriste**

Nxitja, thirrja publike, shpërndarja e shkrimeve ose propaganda në forma të tjera, që synon mbështetjen ose kryerjen e një apo më shumë veprave për qëllime terroriste dhe për financimin e terrorizmit, nëse nuk përbën vepër tjetër penale, dënohet me burgim nga katër deri në dhjetë vjet.

Neni 232/b

### **Kanosja për kryerjen e veprave me qëllime terroriste**

Kanosja serioze për kryerjen e veprave për qëllime terroriste, që i bëhet një autoriteti publik,

edhe të një shteti tjetër, institucioni apo organizate ndërkombëtare, dënohet me burgim nga tetë deri në pesëmbëdhjetë vjet.”.

#### Neni 20

Në nenin 236, në paragrafin e dytë hiqen fjalët “nga tre”.

#### Neni 21

Në nenin 248 fjalët “nga gjashtë muaj deri në pesë vjet” zëvendësohen me fjalët “deri në shtatë vjet”.

#### Neni 22

Në nenin 257/a, paragrafi i dytë ndryshohet si më poshtë:  
“Fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.”.

#### Neni 23

Pas nenit 282/a shtohet neni 282/b me këtë përmbajtje:

##### “Neni 282/b

##### **Stërvitja për prodhimin dhe përdorimin e paligjshëm të armëve e lëndëve të tjera të rrezikshme**

Përgatitja, stërvitja dhe dhënia e udhëzimeve, në çdo formë, edhe në mënyrë anonime apo në rrugë elektronike, në kundërshtim me ligjin, për prodhimin ose përdorimin e lëndëve eksplozive, të armëve të zjarrit dhe municioneve luftarake, të armëve të tjera dhe lëndëve kimike, bakteriologjike, bërthamore apo të çdo natyre tjetër, të dëmshme dhe të rrezikshme për njerëzit dhe pasurinë, nëse nuk përbën veprë tjetër penale, dënohen me burgim nga dy deri në shtatë vjet.”.

#### Neni 24

Në nenin 287 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Shkronja “a” e pikës 1 ndryshohet si më poshtë:  
“a) këmbimit ose transferimit të pasurisë, që dihet se është produkt i veprës penale, për fshehjen, mbulimin e origjinës së pasurisë ose dhënien e ndihmës, për të shmangur pasojat juridike, që lidhen me kryerjen e veprës penale;”.
2. Shkronja “ç” shfuqizohet.

#### Neni 25

Pas nenit 287/a shtohet neni 287/b me këtë përmbajtje:

##### “Neni 287/b

##### **Përvetësimi i parave ose mallrave të vjedhura**

Kushdo që blen, merr, fsheh apo, në një mënyrë tjetër, përvetëson për vete ose një palë të tretë, apo ndihmon në blerjen, marrjen, fshehjen ose përdorimin e parave apo mallrave të tjera, duke ditur se një person tjetër ka përfituar këto para apo mallra, si pasojë e kryerjes së një veprë penale,

dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet dhe me gjobë deri në një qind mijë lekë.

Papërgjegjshmëria e personit ose pengesa për të ndjekur penalisht personin për veprën penale në fjalë nuk përjashtojnë përgjegjësinë e personit, që kreu veprën penale të përvetësimit të parave ose mallrave të vjedhura, sipas këtij neni.”.

## Neni 26

Pas nenit 295 shtohet neni 295/a me këtë përmbajtje:

“Neni 295/a

### **Zbulimi i akteve ose të dhënave sekrete**

Zbulimi ndaj të tretëve i të dhënave ose ndihma për të zbuluar të dhënat, të cilat ligji i përcakton si sekret, nga ana e një funksionari publik ose e një personi të ngarkuar me një shërbim publik, në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës ose duke abuzuar me cilësitë e veta, përbën vepër penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet.

Zbulimi ndaj të tretëve i të dhënave, të cilat përbëjnë sekret tregtar industrial ose profesional, nga ana e personave publikë, që kanë detyrë ruajtjen e tyre, përbën vepër penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.

Zbulimi i akteve sekrete ose i të dhënave, që përmbajnë aktet sekrete, nga prokurori ose oficeri i policisë gjyqësore, si dhe mosrespektimi i detyrimeve të përcaktuara në nenin 103 të Kodit të Procedurës Penale, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

Zbulimi i akteve sekrete ose i të dhënave të përmbajtura në aktet sekrete nga persona të tjerë, që kanë dijeni për të dhëna për procedimin penal e që janë paralajmëruar nga prokurori ose oficeri i policisë gjyqësore për moszbulimin e tyre, dënohet me burgim deri në tre vjet.

Zbulimi i të dhënave sekrete, që kanë lidhje me identitetin, procesin e bashkëpunimit, të mbrojtjes ose për vendndodhjen e dëshmitarëve e të bashkëpunëtorëve të drejtësisë, të cilët përfitojnë mbrojtje të veçantë, sipas ligjeve në fuqi, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga dy deri në gjashtë vjet.

Zbulimi i sekretit që ka sjellë si pasojë vdekjen, plagosjen e rëndë ose ka rrezikuar seriozisht jetën apo shëndetin e dëshmitarëve ose të bashkëpunëtorëve të drejtësisë, të familjarëve të tyre apo të punonjësve të policisë, të ngarkuar me mbrojtjen e tyre, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga tre deri në tetë vjet.”.

## Neni 27

Në nenin 298 bëhen këto ndryshime:

1. Titulli i nenit bëhet “Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve”.

2. Paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë:

“Strehimi, shoqërimi, vënia në dispozicion ose përdorimi i mjeteve të lundrimit, të fluturimit ose i mjeteve të tjera të transportit apo çdo ndihmë tjetër, me qëllim kalimin e paligjshëm të kufirit të Republikës së Shqipërisë ose për hyrjen e paligjshme të një personi në një shtet tjetër, pa qenë shtetas i tij ose që nuk ka leje qëndrimi në atë shtet, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga një deri në katër vjet dhe me gjobë nga tre milionë lekë deri në gjashtë milionë lekë.”.

## Neni 28

Në paragrafin e dytë të nenit 302, pas fjalës “nenet” shtohen: 73, 74, 75, 79, 219, 220, 221, 230, 230/a, 230/b, 231, 232, 232/a.

## Neni 29

Pas nenit 305 shtohen nenet 305/a e 305/b me këtë përmbajtje:

### Neni 305/a

## **Deklaratat e rreme përpara prokurorit**

Kushdo që, gjatë hetimeve apo procedimeve penale, i pyetur nga një prokuror që të japë informacionin e duhur lidhur me hetimin, jep të dhëna, me gojë ose me shkrim, që ai e di se janë, tërësisht ose pjesërisht, të rreme apo fsheh fakte ose prova, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit.

Dispozitat e këtij neni nuk janë të zbatueshme në rast se akti është kryer në çdo fazë të procedimit penal nga një person i dyshuar ose i pandehur për veprën penale ose nga dikush, që duhej të ishte përjashtuar nga kërkesa për informacion apo për të dëshmuar, për çdo arsye të ligjshme, ose që nuk ishte paralajmëruar për të drejtën për të mos dëshmuar apo për t'iu përgjigjur pyetjeve.

Neni 305/b

## **Deklaratat e rreme përpara oficerit të policisë gjyqësore**

Kushdo që, gjatë hetimit, i pyetur nga një oficer i policisë gjyqësore që të japë informacionin e duhur, jep të dhëna, me gojë ose me shkrim, që ai i di se janë, tërësisht ose pjesërisht, të rreme apo fsheh fakte ose prova, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë muaj.

Dispozitat e këtij neni nuk janë të zbatueshme në rast se akti është kryer në çdo fazë të procedimit penal nga një person i dyshuar ose i pandehur për veprën penale ose nga dikush, që duhej të ishte përjashtuar nga kërkesa për informacion apo për të dëshmuar, për çdo arsye të ligjshme, ose që nuk ishte paralajmëruar për të drejtën për të mos dëshmuar apo për t'iu përgjigjur pyetjeve.”.

Neni 30

Në nenin 306, në paragrafin e tretë fjalët “nga një deri në katër vjet” zëvendësohen me fjalët “nga dy deri në gjashtë vjet”.

Neni 31

Në nenin 307 bëhen këto ndryshime:

1. Në paragrafin e dytë, fjalët “me gjobë ose me burgim deri në tre vjet” zëvendësohen me fjalët “me burgim nga një deri në katër vjet”.

2. Në fund të nenit shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Dispozitat e këtij neni nuk janë të zbatueshme në rast se akti është kryer në çdo fazë të procedimit penal nga një person i dyshuar ose i pandehur për veprën penale ose nga dikush, që duhej të ishte përjashtuar nga kërkesa për informacion apo për të dëshmuar, për çdo arsye të ligjshme, ose që nuk ishte paralajmëruar për të drejtën për të mos dëshmuar apo për t'iu përgjigjur pyetjeve.”.

Neni 32

Neni 311 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 311

## **Kanosja për të mos kallëzuar**

Kanosja, që i bëhet të dëmtuarit nga vepra penale, me qëllim që të mos kallëzojë, të ankohej apo të tërheqë kallëzimin ose ankimin e bërë, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga një deri në katër vjet.”.

### Neni 33

Në nenin 312/a “Kanosja për deklarime a dëshmi, ekspertim ose përkthim të rremë”, fjalët “me gjobë ose me burgim deri në tre vjet” zëvendësohen me fjalët “burgim nga një deri në katër vjet”.

### Neni 34

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5218, datë 13.3.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Alfred Moisiu**